

ILJAZ GOGAJ

**PLAGËT E SHKOLLËS SHQIPTARE NË DIKTATURËN
KOMUNISTE
(Arsimi 8-vjeçar dhe i mesëm)**

Pas Shpalljes së Pavarësisë, shkolla shqipe e ngritur si e tillë gjatë sundimit osman, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, nisi të rimëkëmbet dhe në vitet '20-'30 deri aty nga viti 1943, u krijua dhe u konsolidua një sistem arsimor i cili megjithëse i kufizuar në sasi dhe me mangësi materiale, në përgjithësi, në përmbajtje dhe metodë nuk ra më poshtë atij ballkanas, e madje ndonjë shkollë e mesme mund të dilte në krye në sistemin arsimor të Gadishullit tonë. Mirëpo, pas Luftës së Dytë Botërore, ky proces u ndërpre. Duke u doktrinar me ideologjinë komuniste, shkolla mori rrokullimën në dëm të formimit kulturor, qytetar e atdhetar të brezave në Shqipëri.

Me vendosjen e pushtetit komunist nisën “reformat” për përmbysjen e sistemit të “kalbur” arsimor borgjez dhe krijimin e shkollës së re të quajtur socialiste, me frymë “demokratike popullore”. Me synime të qarta politike, filloi masivizimi e zgjerimi i rrjetit shkollor. Brenda dhjetëvjeçarit të parë të sundimit të diktaturës u çelën shkolla fillore, pothuajse në të gjitha fshatrat e vendit. Me dekret të posaçëm, në qershor 1952, u shpall detyrimi ligjor i arsimit 7-vjeçar (më vonë 8-vjeçar)¹. Në këtë kuadër duhej të shtohet edhe numri i mësuesve të improvizuar me anë kursesh të shpejtë, ku u futën persona që në shumicën e tyre nuk kishin as arsimin e mesëm. Kjo mënyrë zgjidhjeje me “rrugë revolucionare”, siç u quajt, shkoi deri aty nga fundi i viteve '50. Në prill 1956, në Kongresin III të PPSH, u shpall me bujë likuidimi i analfabetizmit deri në moshën 40 vjeç të popullsisë².

Në kuadër të “masivizimit të shkollës”, pa bazën e nevojshme materiale dhe me mbështetje të dobët financiare, u zgjerua rrjeti i të gjithë kategorive të shkollave, sidomos i shkollave të mesme katërvjeçare dhe

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi i Kryeministrit, dok. dt. 12.6.1952, nr. 1484.

² Ahmet Kondo, *Lufta kundër analfabetizmit në Shqipëri*, Tiranë, 1985.

atyre të mesme dyvjeçare profesionale, të quajtura sipas sistemit sovjetik, “shkolla të rezervave të punës”. Në vitin 1946 u hap shkolla e parë e lartë në Shqipëri, Instituti 2-vjeçar pedagogjik në Tiranë. Më vonë, në vitet 1951-1954, u çelën katër institute të larta në degë të ndryshme të shkencave,. Nga bashkimi i të cilëve, në vitin 1957 u themelua i pari Universitet në Shqipëri, me 5 fakultete. Deri në këtë vit, kishin kryer shkollat e larta brenda dhe jashtë vendit 1.118 studentë. Në vitet ’70, u ngritën filiale të Universitetit edhe në disa rrethe të vendit, ndonëse kishin mungesa të shumta, për tekste, pedagogë dhe për bazë materiale. Filialet që u hapën madje deri në Kukës, ishin të profilizuara, me specialitete sipas nevojave krahinore. Në pragun e 15-vjetorit të çlirimit u shpall se në Shqipëri kishte 162 nxënës dhe studentë për 1000 banorë, kundrejt 153 në Greqi, 132 në Itali, 85 në Turqi³. Në vitin 1965, në Shqipëri numëroheshin 77 gjimnaze, 28 shkolla të mesme profesionale dhe 22 shkolla të ulëta profesionale (ose të rezervave të punës)⁴. Kurse në vitin 1983 numri i të gjitha shkollave, ishte dyfishi i atyre që funksiononin 20 vjet më parë⁵. Për fat të keq, zgjerimi i rrjetit arsimor, nuk u shoqërua me rritjen e tij cilësore, siç duhej të ndodhte objektivisht, mbështetur në përvojën më të mirë vendëse dhe në botë. Përkundrazi, ai shkoi duke u degraduar në treguesit e tij thelbësorë. Në këtë udhë, deri në fund të viteve 70-të, shkolla në Shqipëri iu nënshtrua modelimeve të vendeve “vëllezër” e “miq”. Më tutje, në përpjekje për “origjinalitet”, për të krijuar të ashtuquajturin “njeriun e ri”, ajo erdhi e u dëmtua keqas në të gjitha komponentët dhe drejtimet e saj.

Arsimi i periudhës 1944-1948, adaptoi sistemin jugosllav më shumë se atë rus, megjithëse ata, deri atëherë ishin shumë të ngjashëm. Sipas sistemit jugosllav, me reformën arsimore të vitit 1946, u hoqën gjuhët klasike dhe u zëvendësuan me serbokroatishten e më vonë me rusishten. U hoqën nga programi disa nga autorët më në zë të letërsisë shqiptare. U fut për herë të parë Historia e Partisë Komuniste të BS dhe ajo e Partisë Komuniste Shqiptare. Lënda e njohur e filozofisë u zëvendësua krejtësisht me marksizmin si filozofi sunduese. Për këtë erdhën edhe specialistë jugosllavë të arsimit.

³ *Arsimi Popullor*, Tiranë, nëntor 1959, f. 23.

⁴ Sotir Temo, *Arsimi në RPSH të Shqipërisë*, Tiranë: 1985.

⁵ *Për revolucionarizimin e shkollës sonë*, I, Tiranë: 1969.

Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, për rreth 20 vjet, shkolla jonë u sundua plotësisht nga shkolla dhe pedagogjia sovjetike, me praninë, deri në fillim të viteve 60-të, edhe të pedagogëve rusë. Politizimi i programeve sipas shembullit të vendit “mik”, largimi i lëndëve mësimore nga kulturat evropiane, masivizimi me synime tejet politizuese, gjithnjë jashtë mundësive materiale të shtetit dhe të familjes, “demokratizimi” i marrëdhënieve mësues nxënës, ishin goditjet e para tronditëse që tjetërsuan shkollën shqiptare, duke ia kaluar edhe shkollës sovjetike, në mangësi dhe, për më tepër, në ngjyrimin e theksuar politik.

Shkurorëzimi tjetër politik, këtë radhë nga Bashkimi Sovjetik, u shoqërua me goditje të tjera shumë dëmprurëse të shkollës në Shqipëri.

Periodha e të ashtuquajturit revolucionarizim i mëtejshëm i shkollës përkon jo rastësisht me forcimin e marrëdhënieve me Kinën. Pasojat i ndjenë ato breza që kaluan ato vite në bankat e shkollës në Shqipëri. Periodha në fjalë zë fill me fjalimin e Enver Hoxhës më 29 dhjetor 1965 në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë, me rastin e 40-vjetorit të themelimit të asaj shkolle, pasuar me fjalimin e 7 marsit 1968, mbajtur prej tij në Byronë Politike të KQ të PPSH “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” dhe mbyllet me fjalën e Hoxhës në Plenumin e KQ të PPSH në qershor 1969. Kjo ishte platforma teorike enveriste për zhdukjen e çdo gjurme të shkollës së “vjetër” në Shqipëri dhe për ta vënë shkollën e re në binarët e politikës së pavarur, që e çoi atë dhe mbarë vendin në izolim të plotë nga bota, gjegjësisht nga kultura botërore.

Nga fundi i viteve 70-të, pas prishjes së re të marrëdhënieve me R.P. Kinës, shkolla u fut edhe më thellë në politizim çka e dëmtoi edhe më keq formimin kulturor të brezave në shkollim. Në vitin 1982, diktatori kërkoi me këmbëngulje që të gjitha lëndët, tekstet, leksionet, metodat e dhënies së mësimin, eksperimentet dhe praktikat, të zhvilloheshin në përputhje me ideologjinë e Partisë⁶.

Aq thellë u fut shkolla në mjegullën e politikës, sa që të gjitha lëndët, në të gjithë kategoritë e shkollave, nga foshnjorja e deri në Universitet, duhej të përshkoheshin nga politika e Partisë. Edhe problemet e matematikës duhej të kishin përmbajtje nga realiteti socialist shqiptar. Kudo në të gjitha lëndët duhej të citohej vepra e Enver Hoxhës. Në kabinetet e fizikës dhe matematikës, në vend të civateve dhe portreteve të Njutonit, Ajnshtajnit dhe shkencëtarëve të tjerë, ishin

⁶ Enver Hoxha, *Raport në Kongresin VII të PPSH*, Tiranë: 1976, f. 174.

vendosur portretet dhe citatet e Enver Hoxhës. Edhe metoda e mësimdhënies u kërkua që të gjente frymëzim për efikasitet vetëm në ideologjinë staliniste. Një nga krerët e njohur të regjimit Manush Myftiu, zv.kryeministër dhe i ngarkuar për arsimin dhe kulturën, do të deklaronte më 1972: “Metoda e dhënies së mësimi, është në radhë të parë një çështje ideologjike, metoda materialiste dialektike e Stalinit, si e vetmja metodë e drejtë shkencore në fushën e dhënies së mësimi”⁷. Kjo në të vërtetë pasqyrore frikën e regjimit ndaj shkollave pedagogjike perëndimore. Absurditeti shkoi deri aty, sa që “Didaktika”, tekst i Universitetit, botuar pas vdekjes së Enver Hoxhës, kishte 70 citate nga veprat e tij, 26 nga klasikët e marksizëm leninizmit, 8 nga pasardhësi i Hoxhës, Ramiz Alia dhe asnjë nga Komenski apo baballarë të tjerë të pedagogjisë botërore. Në bazë të kësaj platforme pedagogjike hoxhiane, në kushtet e izolimit të plotë nga bota, të shkatërrimit të ekonomisë dhe të varfërimit të popullit, shkolla po degradohej në vetvete.

Ndër plagët më të mëdha që i solli shkollës regjimi politik hoxhian në Shqipëri, edhe brenda atij kuadri si institucion me përmbajtje komuniste, ishte dëmtimi i personalitetit të mësuesit, që nisi menjëherë pas Luftës.

Duke sajuar kultin e vet, në valën e entuziazmit të “fitores” dhe të “çlirimit”, si edhe të nevojës së natyrshme jetësore për ndryshim e ripërtëritje, regjimi hoxhian, që në fillim, nisi luftën sistematike kundër inteligjencies, bërthamën e së cilës në atë kohë e përbënin mësuesit. Në kuadër të likuidimit të opozitës demokratike, dhjetëra mësues u pushkatuan apo vdiqën në burgje. Qindra të tjerë u burgosën ose u persekutuan në forma të tjera, vetëm e vetëm se mendonin ndryshe, ose kishin shfaqur rezerva ndaj reformave. Në vijim, lufta e klasave që në Shqipëri arriti në skajet fatale, përjashtoi nga arsimi dhe hodhi në rrugë mësues cilësorë me emër, për të cilët shkolla kishte aq shumë nevojë. Ndërsa disa të tjerë i përzuri nga shkollat e mesme dhe i çoi në shkolla fillore. Të tjerë i degdisi nëpër fshatra, ku u robëtuan deri në daljen në pension.

Në këtë mënyrë, nga njëra anë pakësimi i mësuesve me shkollim të plotë perëndimor, në anën tjetër shtimi i madh e pa kriter i shkollave, e bëri gjithnjë deficitar për mësues të kualifikuar arsimin. Krahas këtyre ndikoi negativisht rritja artificiale e notës mesatare dhe kalimi me plan 100% i pjesës dërrmuese të nxënësve, mbajtja e klasave me 30-40 e më shumë nxënës, mësimi pasdite kushtëzoi për fëmijët me nënat në punë të

⁷ *Didaktika*, botim i Universitetit të Tiranës, Tiranë: 1989.

vinin në shkollë nga rruga, të pangrënë, të palarë dhe shpesh të papajisur me mjetet më të domosdoshme shkollore. Nga këto mangësi, shkolla vuajti deri në fund të regjimit komunist. Veç kësaj, shpërpjesëtimi gjithnjë e më i madh në norma të papranuara pedagogjike i raportit mësues nxënës, rëndoi së tepërmi punën e mësuesit, deri në stërmundim. Për më keq, ngarkesa javore e mësuesit në Shqipëri do të ketë qenë nga më të lartat në botë, me 24 – 25 orë në javë e nganjëherë mund të gjeje edhe në kryeqytet mësues matematike me 27 orë mësim në javë.

Për plotësimin e normës së lartë javore mësuesit jepnin mësim edhe krejtësisht jashtë profilit veçanërisht në fshat, ku frekuentonin shkollën 65% e nxënësve të vendit, kjo ishte një dukuri e rëndomtë me pasoja të theksuara në nivelin e dijeve. Përveç normës së lartë mësimore, mësuesi në Shqipëri, sidomos në provincë qe i ngarkuar me sa e sa detyra e punë të shumta “vullnetare”, në veprimtaritë e pafund jashtëshkollore. Në fshat mësuesi do të bëhej veç të tjerave agjikator i Partisë për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Kështu, ngarkesa e madhe e barrës së punës, tensioni përherë e më i shtuar nga jeta politike e vendit, do të ulte përherë e më ndjeshëm cilësinë e punës së mësuesit. Edhe paga e vogël nuk shkonte në të mirë të cilësisë së punës së tij të lodhshme. Arsimtari me dhjetë vjet vjetërsi pune merrte rrogën e një tekniku e të një elektrikisti. E keqja edhe më e madhe, ishte se pagat e ulëta u shoqëruan me mungesa të theksuara të sendeve të konsumit, sidomos të produkteve me përmasa të paimagjinueshme veçanërisht në vitet 80-të. Puna e mësuesit ishte tepër e vështirë dhe e përcjellë me shumë privacione sidomos në fshat. Mësuesit e fshatit vuanin shumë nga largësia e vendit të banimit, kushtet e mungesës së mjeteve të transportit, të veshjes, aq më tepër kur udhëtonin në këmbë, rrugë e pa rrugë. Veç të tjerave, ata duhej të përballonin dhimbjen shpirtërore të realitetit rrënjëthës të zbatharakëve të fshatit, të cilët, të ushqyer, veshur e mbathur mos më keq, vinin duke u dridhur në atë lokal që quhej shkollë. Sipas të dhënave zyrtare të dokumentuara, fshatarët shqiptarë të Shqipërisë së Veriut, në vitet '80, hanin mesatarisht 140 gr mish në vit⁸. Duhet vënë në dukje në këtë mes, puna e madhe e shumë e lodhshme e mësuesve të fshatit. “Ato të urtat deri në dhembje/ të thjeshtat deri në madhështi”, siç i ka quajtur

⁸ AQSh, Fondi i Kryeministrisë.

poeti⁹, vajza të reja, që shkrinë lulen e moshës nëpër shkrepa e gërxe, (e pse jo edhe gjithë jetën, si në internim), larg familjeve të tyre. Dikur mësuesi në Shqipëri, para luftës, kishte një autoritet të padiskutueshëm, çka ishte faktor me rëndësi për punë të suksesshme. Ndërsa rendi politik shoqëror që u vendos në Shqipëri pas Luftës rrënoi edhe autoritetin e mësuesit. Dhe e keqja kishte shkuar deri aty sa që nxënësi mund të kundërshtonte dhe të ofendonte mësuesin, në mes të klasës pa pasur pasoja serioze veçanërisht në se ishte “nga familje me përbërje të mirë politike”.

Goditjen e parë autoriteti i mësuesit e mori që në fillim kur u shpik termi socialist “shoku mësues” në vend të termit borgjez “zoti mësues”. Në mënyrë paradoksale me synime të përcaktuara politike, diku hapur e më shumë fshehur, organizata e rinisë doli mbi këshillin pedagogjik dhe erdhi një kohë që drejtori kishte frikë nga sekretari i rinisë. Shkallë, shkallë reforma pas reformash direktivë pas direktive nga lart, autoriteti i mësuesit shkoi gjithnjë në rënie dhe ai vetë po e ulte kokën përherë e më shumë¹⁰.

Në Shqipëri mungoi një status juridik për mësuesit, i cili të rregullonte marrëdhëniet e mësuesit në shkollë dhe në shoqëri, si figurë e dorës së parë në zhvillimin kulturor të vendit. Politika e kohës donte t’i mbante mësuesit gjithnjë në gjendje të nënshtruar, mbasi te shtresa e tyre intelektuale, vështronin mundësinë më të madhe të “infektimit” nga ideologjia borgjeze revizioniste dhe për pasojë të rrezikut potencial për fatet e socializmit, me anën e ndikimit të tyre mbi rininë shkollore¹¹.

Pas fjalimit të diktatorit në gjimnazin “Qemal Stafa”, ku ai pohoi se po të ishte mësues, që orën e parë të mësimit do t’ju fliste nxënësve për të metat e tij, kuptohet lehtë vetiu, se çfarë do të ndodhte dhe çfarë ndodhi, kur ai do të theksonte më tej se “kurrë nuk duhet të prishet qejfi i fëmijëve, kur ata bëjnë ndonjë shejtanllëk”¹². Edhe rreth 25-30 vjet pas çlirimit, diktatori nuk do të harronte kurrë të potenconte rrezikun që i vinte shkollës nga “konservatorizmi” i mësuesve të vjetër¹³. Ai nuk e zuri kurrë në gojë çështjen e ngritjes së autoritetit të mësuesit pale për

⁹ Gjergj Xheji, “Për të gjitha shkollat dhe drejtimet”, *Rilindja Demokratike*, Tiranë, dt. 22.2.1996.

¹⁰ *Për revolucionarizimin e shkollës*, III, Tiranë: 1972.

¹¹ Suzana Franger, “Pasqyrimi i sistemit arsimor dhe i zhvillimit të shkencës në Shqipëri, në librin *Albanien*”, *Rilindja*, Tiranë: 16. 10.1994.

¹² Enver Hoxha, *Raport në Kongresin VII të PPSH*.

¹³ *Reforma arsimore në vendet e Evropës Qendrore e Lindore*, Tiranë: 1995.

respektin që duhej pasur për mësuesit e vjetër, siç mund të meritonin, por përkundrazi pati paturpësinë t'i quajë "hauret e Ozhiasit"¹⁴ ata pedagogë të cilët ishin formuar me kulturë oksidentale në Universitetet e Austrisë, Francës dhe Italisë.

Në vitet 70-të u fut si normë në punën e shkollës që mësuesit të jepnin llogari sistematikisht para nxënësve dhe nxënësit të kritikonin mësuesit nga këndvështrimet politike dhe pedagogjike.

Rënia e autoritetit të mësuesit e çoi rregullin dhe disiplinën në një shturje të paparë në një liberalizim vulgar, në një amulli çoroditëse. Atë të ashtuquajtur rregull dhe disiplinë, një disiplinë mekanike prej njerëzish të nënshtuar e indiferentë e mbante në këmbë me paterica, institucioni i policisë së mendimit, i cili i pranishëm në çdo qelizë të jetës së vendit, dëmtoi keqas personalitetin e njeriut.

*

* *

Lëndët formuese në shkollë, lëndët e shkencave shoqërore kryesisht historia dhe letërsia, u sakatuan dhe u shtrembëruan në atë shkallë, sa që gjymtuan rëndë formimin e përgjithshëm të disa brezave në Shqipëri.

Lënda e historisë u vu tashmë tërësisht në shërbim të një propagande që i shërbente ruajtjes dhe forcimit të regjimit shtetëror. Për t'i shërbyer sa më mirë këtij qëllimi, parimi themelor i udhëheqjes së lëndës së historisë në shkollë u shpall e u ligjërua ai i partishmërisë, si më real për saktësinë shkencore të ngjarjeve figurave që i mbartnin ato. Në të gjitha tekstet e historisë, duke pakësuar ose duke injoruar fare faktorët e dukuritë politike e kulturore që objektivisht duhej të zinin vendin kryesor, falë aplikimit të skemave shabllone të materializmit historik, në vend të tyre dominuan faktorët ekonomikë e shoqërorë të procesit historik. Pastaj duke i mëshuar luftës së klasave, krijohesh përshtypja e gabuar historike, sikur njerëzimin e kanë çuar përpara, vetëm revolucionet me dhunë.

Sipas "parimit" klasor që u përshtat dhe zbatua në Shqipëri u deformua e vërteta, le të përmendim p.sh. se roli i feudalëve shqiptarë në kryengritjet antiosmane të Mesjetës iu vesh në mënyrë skematike fshatarësisë¹⁵. U anatemua titulli "bej" dhe tituj të tjerë në shkallëzimin e hierarkisë shoqërore e politike dhe u mohua roli i tyre në lëvizjen

¹⁴ *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës*, Tiranë: 1972.

¹⁵ *AQSh*, Fondi i Kryeministrisë, dok. dt. 26.4.1987. Raport i zv.kryeministrit Manush Myftiu në mbledhjen e qeverisë.

kombëtare shqiptare, duke ia atribuar të gjitha meritat kryesisht masave popullore. Më vonë, për periudhën e Pavarësisë iu atribuan merita krejt të paqena komunistëve në lëvizjen progresive të vendit. Në kundërshtim të hapur me të vërtetën historike të dokumentuar, tekstet e historisë e vizatuan me ngjyrat më të errëta regjimin e Zogut. Historia e Luftës Antifashiste Çlirimtare dhe ajo e periudhës së “socializmit”, me gjykimet faktologjike, me vulgarizimin e interpretimit dhe me glorifikimin e kultit të Enver Hoxhës, dhanë një tablo sa të rreme aq edhe qesharake të vërtetës historike. Mënjanimi ose lënia në heshtje e trashëgimisë mëkatore të shekujve, që kishin zënë fill në udhëkryqe dhe turbullime të ngjarjeve historike nën pushtime të huaja, si edhe përkundja në shtratet e buta përkëdhelëse të ngadhënjimeve të bujshme dhe traditave të shkëlqyera pas vitit 1941, e ç’ndërgjegjësuuan nxënësin nga e vërtetat historike dhe për pasojë e prirën të largohet dhe në të vërtetë, realisht, të jetë indiferent ndaj traditës e të kaluarës në përgjithësi.

Historia botërore e të gjitha kohërave në tekstet shkollore u vështrua nën optikën ideologjike dogmatike të marksizmit, të përzier me disa ide fikse, të cilat u paraqitën si krijimtari vitale e udhëheqësit të “shquar” marksist-leninist Enver Hoxha.

Formimi i nxënësve shqiptarë kaloi hera-herës, në vulgaritete qesharake neveritëse për imazhin aq të shtrembër që morën për të figurat historike botërore në përgjithësi. Dikur, kur po flitej në një rreth miqsh për meritat e një mbreti reformator evropian, një nxënës i shkollës 8-vjeçare i pranishëm ia priti të atit aty pranë: “Babi, s’ka mbret të mirë, të gjithë janë të liq ...”¹⁶. Një herë tjetër, kur propagandës shqiptare iu desh të mbajë qëndrim objektiv ndaj politikës së presidentit të Qipros peshkopit Makarios, biri që kish parë gazetën i tha të atit: “Pse, baba, ka prift të mirë”? Dhe i ati komunist i vendosur, tërthorazi do të mburrej publikisht për formimin “objektiv” të të birit¹⁷.

Programet mësimore që ndërtoi diktatura në Shqipëri sipas teorisë së realizmit socialist, si p.sh. letërsia, si degë e rëndësishme e artit dhe e kulturës, më delikatja midis lëndëve humanitare, me prirjet gënjeshtarë, me cungimet dhe me mangësitë, me shformimet e realitetit, dëmtoi së tepërmi formimin kulturor artistik e etik të nxënësve në të gjitha ciklet e shkollave. U fshinë emrat e mjaft figurave me peshë në letërsinë

¹⁶ Abdi Baleta, *Zëri i Rinisë*, Tiranë: 9.9.1992.

¹⁷ *Për revolucionarizimin e shkollës*, I, Tiranë: 1969, f. 64.

shqiptare e madje disa u dënuan si kundërshtarë të komunizmit si “reaksionarë”. Ndër ta At Gjergj Fishta, Faik Konica, Ernest Koliqi, Et’hem Haxhiademi etj. Për më tepër, deri në vitet ’80-të nuk flitej fare për letërsinë shqipe në Kosovë dhe troje të tjera shqiptare në ish Jugosllavi.

Boshllëk të madh në formimin kulturor të nxënësve që cungimi deri në zero, jo vetëm i historisë greko-latine, por edhe i letërsisë së lashtësisë, së bashku me letërsinë e Rilindjes evropiane dhe sidomos të letërsisë dhe të artit të Rilindjes italiane, ku janë themelet e qytetërimit modern evropian.

Kaluan disa breza maturantësh, të cilët nuk morën asnjë njohuri nga letërsia bashkëkohore botërore dhe as dëgjuan emrat e disa prej kolosëve, të cilët, kishin pasur ndikim të jashtëzakonshëm në historinë e letrave në botë. Në vend të tyre u fut në programe letërsia e Komunës së Parisit dhe vërshuan të përkthyer me porosi nga “Iart” për pasurimin e bibliotekave të shkollave, letërsi nga vendet e Amerikës Latine, nga Azia dhe nga prodhimi vendës i socrealizmit, që të gjitha pa asnjë vlerë të spikatur artistike. Kurse nga letërsia bashkëkohore greke, vetëm ndonjë libër Janis Ricos apo Kazanzaqisit mundi të përkthehet në Shqipëri.

Nga plagët e tjera që i solli shkolla socialiste formimit të nxënësve, ishte skarciteti i madh në gjuhën shqipe. Hartimet, diktimet, gjithë detyrat me shkrim në lëndë të tjera, ishin dëshmi e dobësisë së theksuar të nxënësve në gjuhën e shkruar amtare. Shqetësimi që tronditës dhe në vitin 1976, lënda e gjuhës shqipe e hequr dikur nga programet e shkollës së mesme, u fut sërishmi në programet e klasave të para të gjimnazit. Por kjo nuk dha ndonjë përmirësim të dukshëm, sepse ende punonte dobët shkolla themeltare, 8-vjeçarja. Në mes të kryeqytetit, mund të gjeje jo pak nxënës, të cilët kryenin klasën e 8-të dhe paraqisnin dobësi të theksuara në shkrimin korrekt të gjuhës shqipe.

Së bashku me dobësitë në gjuhë e letërsi, në formimin e nxënësve do të ndikonte keq edhe mungesa e theksuar e letërsisë së huaj plotësuese jashtë klase. Në periudhën e kulmit të marrëdhënieve me BS, librat ruso-sovjetike, zinin vendin e parë në mënyrë të dukshme. Nga të 145 titujt e librave të rekomanduara, pra të detyruara për shkollën 8-vjeçare, 73 ishin nga autorë të BS, 39 nga autorë shqiptarë dhe 33 nga shkrimtarë “progresistë” nga vende të tjera që kritikonin rendin kapitalist¹⁸. Pas prishjes me BS u bë mbyllja e rreptë me botën. Shkollës shqiptare iu

¹⁸ Kleanthi Zoto, “Çka i ka munguar dhe i mungon shkollës sonë”, *Bashkimi*, Tiranë, 14.6.1992, nr. 38.

pre në burimet ku ka marrë dhe merr jetë lëvizja arsimore nëpër botë. Hyrja dhe leximi i literaturës së huaj u quajt sakrilegj dhe nisën masat e ashpra që shkuan edhe deri në penaltet. Me urdhër të qeverisë u hoq nga qarkullimi literatura e huaj dhe kaloi nën emrin “rezervat” të bibliotekave, ku mund të shfrytëzohej vetëm me autorizime të posaçme. Më 1968 kryeministria urdhëronte asgjësimin e të gjithë katalogëve dhe fotografive të modës perëndimore që ndodheshin në disa arkiva institucionesh të specializuara¹⁹. Në vijim të politikës konsekuente obskurantiste, qeveria do të jepte më vonë urdhëra për kontroll të rreptë sepse “brenda arkave të makinerive që importoheshin nga vendet kapitaliste dhe revizioniste, krahas dokumentacionit përkatës teknik, është futur literaturë reaksionare”²⁰. Sipas krerëve të regjimit kjo ishte “shprehje konkrete e luftës dhe presionit ideologjik që bëjnë armiqtë imperialistë-revizionistë kundër vendit tonë”²¹.

Për të kufizuar edhe atë pak literaturë teknike që shteti ishte i detyruar të pranonte, me vendime të posaçme të qeverisë të vitit 1974 dhe 1975 ndalohej kategorikisht çdo shkëmbim apo huazim libri e periodiku, me vendet kapitaliste e revizioniste. Me disa vende të caktuara, si Franca, Italia ose Austria i njëhej e drejta për huazim vetëm Bibliotekës Kombëtare në Tiranë dhe Bibliotekës së Universitetit²², ku librat mund të shfrytëzoheshin në sallat e bibliotekave me autorizime, për njerëz me garanci politike. Për të arritur në kufijtë më absurdë të antikulturës dhe të arrogancës, në gjysmën e dytë të shekullit të '20, shteti komunist shqiptar do të ndalonte të huajt që hynin në Shqipëri, të merrnin libra me vete për lexim vetjak. Vendimi i posaçëm i qeverisë, thoshte shprehimisht se literatura e huaj “ju sekuestrohej për ditët e qëndrimit në Shqipëri dhe ju kthehej vetëm kur të largoheshin nga Shqipëria”²³. Një vendim tjetër i Këshillit të Ministrave i vitit 1976 i përsëritur më 1982, kërkonte kontroll të vëmendshëm në pikat doganore për të huajt, si për librat dhe për shiritat e magnetofonit²⁴. Vetë diktatori tregoi një zell të veçantë për të penguar që të hynte në Shqipëri edhe nga fondi i literaturës pedagogjike më progresive të botës. Ata që morën iniciativën për të botuar fare të

¹⁹ *AQSh*, Fondi Kryeministria dok. dt. 21.5.1973, nr. 1191.

²⁰ *Po aty*, Fondi Ministria e Punëve të Brendshme, dok. dt. 12.10.1982.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, Fondi Kryeministria dok. dt. 25.4.1974, nr. 871, 8.1.1975, nr. 8.

²³ *Po aty*, dok. dt. 20.6.1973, nr. 1282.

²⁴ *Po aty*.

cunguar “Emilin” e Rusoit, ai i quajti njerëz me lakra në kokë, kur vetë deklaroi se e kishte të plotë veprën e Rusoit në bibliotekën e tij personale²⁵.

Pengesë për depërtimin e kulturës botërore në shkollën dhe kulturën shqiptare në përgjithësi, u bë tërthorazi edhe mangësia e theksuar e njohjes së gjuhëve të huaja.

Menjëherë pas reformës së vitit 1946 u hoqën gjuhët e huaja përëndimore, të cilat, dikur kishin qenë mjete efikase të rëndësishme për ushqimin e intelektualëve që do të bënin emër në Shqipëri. Në vend të tyre u vendos serbokroatishtja e më vonë pas prishjes me jugosllavët erdhi në mënyrë dominuese rusishtja. Si gjuhë e huaj që vinte nga një vend i madh “mik”, rusishtja ruante në vetvete edhe detyrën e kanalit të depërtimit të kulturës e të qytetërimit ruso-sovjetik në Shqipëri²⁶. Me gjithë shtrirjen e saj të madhe kohore për 8 vjet me radhë në shkollë dhe angazhimin e dukshëm zyrtar, gjuha ruse nuk dha asnjëherë rezultatet e dëshiruara.

Pas prishjes me rusët, në shkollat shqiptare u futën gjuhët përëndimore anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht me orë të pamjaftueshme, gjë që nuk krijoi hapësirën e nevojshme kohore për të mundësuar përvetësimin e shëndoshë të tyre. Këtu dëmtoi edhe ngulmimi në metodën e mësimdhënies mbi gramatikën, përvetësimin e pjesshëm të fjalorit, vetëm sa për të lexuar, kurse me praktikë bisedimi tepër të kufizuar. Në këtë mes ka vendin e vet negativ, ndalimi i rreptë i bisedimeve me të huajt kur mund të jepej rasti dhe në fund kërkesa absurde e autoriteteve përkatëse, që në procesin mësimor të gjuhës së huaj, të mbylleshin dyert e përthithjes së qytetërimit të asaj gjuhe nëpërmjet literaturës.

Ndërmarrja e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës, me futjen e të ashtuquajturit trekëndësh revolucionar “mësim punë prodhuese, edukim fizik dhe ushtarak” të përshkuar tejndanë nga boshti ideologjik “marksist-leninist”, me kohën që grabiti në kurriz të mësimin dhe me çoroditjen që solli në tërë punën e shkollës, shkaktoi plagën më të madhe arsimit shqiptar.

Puna prodhuese dhe edukimi ushtarak, zinin rreth 1/3 e vitit efektiv shkollor. Në vitet e fundit të shkollës së mesme, pas matematikës, orët më të shumta në program i kishte edukata fizike e ushtarake. E

²⁵ Enver Hoxha, *Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimin liberal ndaj tyre*, Dokumente kryesore të PPSH, vëll. 6.

²⁶ Vitore Angoni, “Rreth gjendjes së gjuhës ruse në shkollën tone”, *Arsimi popullor*, prill 1959.

megjithatë, Nexhmije Hoxha, së cilës i peshonte shumë fjala, nuk ishte e kënaqur dhe do të kërkonte edhe më shumë, sepse, sipas saj, mbetej mënjana detyra e mbrojtjes së atdheut²⁷.

E keqja tjetër e madhe ishte shthurja e disiplinës e cila rrodhi nga heqja e gradave dhe “demokratizimi” i marrëdhënieve vetjake që rrafshoi hierarkinë ushtarake. Kjo e bëri jo vetëm pa efektivitet, por e çoi edhe në mërzë e bile e bëri edhe qesharake stërvitjen ushtarake të shkollarëve.

Edhe puna fizike prodhuese, sa kohë ka të bëjë me stërvitjen e krahëve dhe të trupit si edhe nxjerrjen prej punës dhe mundit, të një prodhimi ose të një veprë të dobishme, duhej të kishte efektivitetin e saj në përgatitjen e nxënësve. Por fatkeqësisht edhe këtu, si një synim në vetvete i diktaturës, puna prodhuese nuk qe veçse një dështim. Megjithëse diktatura me propagandën e saj shurdhuese, pretendoi se shkolla do të nxirrte njeriun e punës dhe për punë, në të vërtetë, e largoi rininë shkollë nga puna dhe madje e çoi në përbuzje ndaj punës së krahut. Së pari, e ashtuquajtura punë prodhuese nuk bëhej asnjëherë sipas prirjeve të nxënësve dhe përgatitjes së tyre teorike. Në këtë mënyrë, pati mungesë të theksuar efikasiteti të lidhjes së mësimin me punën. Puna prodhuese ishte e organizuar dobët ku nxënësit shkonin edhe për të pastruar territorin e fabrikës se nuk kishte front tjetër ku t’i angazhonin, pa robe pune, shpesh me vegla të këqia dhe më në fund, pa kurrfarë shpërblimi, qoftë edhe simbolik. Tërë këto e kthyen atë në një punë angari. Torturë për nxënësit dhe mësuesit ka qenë higjienizimi i mjedisit shkollor, ku duhej të binin nga shtëpitë e tyre mjete të ndryshme pastrimi, madje dhe kova me ujë, shishe etj.

Përfundimisht të dy komponentët, të futura me përdhunë në shkollë me qëllime të caktuara politike, pa kurrfarë përvoja edhe në rastet më fatlume të zhvillimit të tyre, sollën shumë hardallosje që prekën keqas komponentin më të rëndësishëm të shkollës: mësimin.

Me një buxhet shtetëror të varfër, i cili varfërohej gjithnjë e më shumë (erdhi një kohë pa kredi dhe nga jashtë) nga politika aventureske staliniste e industrializimit socialist të vendit dhe aparatit të rënduar burokratik e policor të shpenzimeve kolosale për mbrojtjen e vendit nga armiqtë inekzistentë, buxheti i arsimit mbeti gjithnjë raktik. Në vijim të kësaj politike, pa llogaritur dëmet e mëdha që i shkakttoheshin shoqërisë, ende të prapambetur shqiptare, shkurtimet më të mëdha në buxhetin e

²⁷ *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës*, Tiranë: 1972, f. 120.

shtetit, kur vinte nevoja, bëheshin pikërisht në fushën e arsimit, si sektor “jo prodhues”.

Tendenca e mbarsur me qëllime politike për të shtrirë gjerë rrjetin shkollor të vendit, bëri që përball buxhetit të varfër të ngriheshin lokale shkollore të papërshtatshme e të pamjaftueshme (sipërfaqe e kubaturë) në fshat madje edhe në qytetet kryesore së bashku me kryeqytetin. Lokalet shkollore me pretendime arkitektonike e pedagogjike, të ngritura me lëndë të dobët ndërtimi dhe të mbajtura edhe më keq, degradoheshin shpejt. Në shkollat e qyteteve vështirë të gjeje lokal pa xhama të thyer qoftë edhe në palcën e dimrit. Përveç cilësisë së dobët, lokalet shkollore qenë gjithnjë me sipërfaqe dhe kubaturë të kufizuar, me 40-45 nxënës në një klasë, dhe me tre veta në banga të ngushta dhe aspak komode, edhe në kryeqytet. Përveç inkonveniencave pedagogjike të kontrollit të nxënësve dhe disiplinës në klasë, krijohej një ambient i rëndë antihigjenik, sidomos në shkollat 8-vjeçare. Më në fund, Shqipëria mund të ketë qenë i vetmi vend në botë me lokale shkollore pa ngrohje qendrore. Edhe ngrohja tradicionale me dru zjarri ka lënë shumë për të dëshiruar, për të mos thënë se nuk ka ekzistuar fare edhe në kryeqytet.

Faktorë të tjerë përcaktues, siç janë tekstet shkollore, kanë paraqitur të njëjtën tablo dëshpëruese. Është e vërtetë se librat shkollore kanë qenë të lirë të përballueshëm për xhepat e shqiptarëve, por kanë qenë gjithnjë të një cilësie të dobët. Zor se mund të jetë gjendur vend në botë, në periudhat bashkëkohore, i cili të ketë pasur tekste shkollore më të këqija teknikisht dhe më të shëmtuara estetikisht se në Shqipërinë socialiste. Asnjëherë në Shqipëri nuk pati tekste për të qenë. Edhe aty nga fundi i viteve 70-të e më vonë, kur u hodh ndonjë hap përpara, librat e nxënësve të shkollës ishin ende shumë larg standarteve ballkanike. Përveç dobësisë, shkolla dhe nxënësit e saj vuajtën shumë nga mungesa e librave. Kjo ka ndodhur si nga buxheti i varfër i shtetit, ashtu edhe nga ndryshimet e thjeshta sipas koniunkturave politike që ndiqte shteti shqiptar, të cilat sillnin “Vjetërimin” e shpejtë të teksteve, sidomos ato të lëndëve humanitare.

Qëllimi i partisë-shtet ishte ta bënte shkollën mjetin kryesor të indoktrinimit komunist. Nuk ishte themelore brumosja e brezave me kulturë të shëndoshë për përparimin e vendit, por përgatitja e armatave verbërisht besnike, të nënshtruara dhe luftëtarë për të mbrojtur “fitoret” e socializmit, për të siguruar konsolidimin dhe formimin e regjimit të shtetit policor. Prandaj jo rastësisht, revolucionarizimi i shkollës u

shoqërua me rënie e theksuar cilësore të saj. Diktatori do të këmbëngulte me atë pedantizmin e tij prej xhandari, se detyra e parë e shkollës ishte ajo e “edukimit dhe e kalitjes revolucionare të rinisë”²⁸. “Mësimet e tij ishin rrënimtare kur do të kërkonte që mësuesi të mos përpiqej të mbushte menjëherë kokën e një 17 vjeçari me dijet e tij 40 vjeçare. Ose kur mësuesi e shihte që nxënësit nuk ishin përgatitur në mësim, ai t’i këshillonte ata, por të mos i pyeste për atë mësim. Në vijim mësuesi i “madh” i popullit do të këshillonte mësuesit e shkollës që t’ju jepnin nxënësve ajkën e lëndës dhe “ujërat e tepërta le të kalonin”²⁹.

Sipas mësimave të Partisë, mekanizmi i vlerësimit të nxënësve me anën e notës, filloi të bëhej fatal në përvetësimin e sakatuar, të përciptë të diturisë, nga brezat që dolën nga shkolla. Nota u katandis në një mjet formal, sa nxënësi ishte i sigurt se çfarë do notash që të kishte marrë gjatë vitit shkollor, gjithsesi, do ta kalonte klasën. Përqindja e kalimit ishte normë e njohur e caktuar nga shteti, i cili planifikonte jo vetëm nxënësit që do të kalonin klasën, por dhe ata që do të diplomoheshin. Kjo dukuri ishte veshur si gjithçka tjetër me rrobën politike. Përqindja e ulët e kalimit mund të diskreditonte sistemin “socialist” në Shqipëri, më të “përparuarin” në botë (sic). Me sintagmën “dhjeta jonë është plumb për armikun” ndërseheshin në një garë euforike të kurdisur nga lart, me dhjetëra gjenerata nxënësish. Sajohej një kalueshmëri e lartë fallto, e cila nxirrte skarcitete mbas skarcitetesh. Më i madhi dhe më i rrezikshmi, ishte dëmi moral, në një pjesë të madhe të rinisë, që nxiti dembelinë dhe plogështinë mendore, përtacinë, nënën e shumë të këqijave, shtoi taborin e atyre që besonin në mundësinë e sigurimit të jetës me dokumentin shkollor³⁰. Edhe më tutje u bë kërdia në shkatërrimin e personalitetit njerëzor me teorinë e “barazimit të ngurtësuar, që shoqërohet detyrimisht me mungesën e iniciativës, frikën e rrezikut, ndjenjën e pafuqishmërisë dhe mosnjohjen, padijen e alternativave të mundshme”³¹. Kjo teori famëkeqe, frenoi e dogji sa e sa talente e prirje, në anën tjetër i hapi udhën gjysmakëve të kulturës.

²⁸ E. Hoxha, “Inteligjencia jonë rritet dhe zhvillohet në gjirin e popullit”, *Vepra*, vëll. 23.

²⁹ *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, vëll. I, Tiranë: 1969, f. 9.

³⁰ Sotir Temo, *Arsimi në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Tiranë: 1985.

³¹ K. Zoto, *art. i cit.*

Keq u dëmtua në këtë mes edhe personaliteti i mësuesit, i cili u përpëliti për dekada të tëra nën presionin e shtetit, që prirëj nga dogma, se nuk kishte nxënës të këqij e të vështirë, po kishte mësues të pazotë, të cilët nuk ishin të aftë të bënin nxënësit që të mësonin.

*

* *

Për të tërhequr sa më shumë kohë në shërbim të edukimit politik, sipas idesë së Leninit, u rrit shumë roli i veprimtarisë jashtëshkollore me karakter “kulturor”, “artistik” e “sportiv”. Nxënësit kur u përdorën pa të keq, duke u hequr nga koha e studimit ose edhe nga vetë ora e mësimi, për të shkuar në përgatitjet e provat për aktivitetet e ndryshme që zhvilloheshin me rastin e festave, kongreseve, pritjeve të delegacioneve të huaja etj. Vetëm për një spektakël-paradë, ose një spartakiadë, të cilën do ta shihte udhëheqja e lartë e Partisë dhe e shtetit, harxhoheshin me stërmundim të madh fizik e tension nervor, orë e ditë të tëra, pse jo edhe netë, që sukcesi të ishte i garantuar.

Për të ruajtur rininë nga “infektimi” i ideologjive të huaja të “rezikshme”, në të vërtetë për ta tërhequr sa më shumë vëmendjen e rinisë nga realiteti i hidhur i jetës, u përdorën shumë aksionet “vullnetare” të punës së krahut, kryesisht në bujqësi ose ndërtime të ndryshme të mëdha, larg vendit të banimit, të organizuara në kampe të mëdha pune dhe banimi së bashku me mësuesit. Punë angari e papaguar për individin dhe realisht pa efikasitet për shtetin ishin aksionet e rinisë, vazhdonin sepse konsideroheshin shkollë e madhe e edukimit “revolucionar” të rinisë. Në të vërtetë, të organizuara sipas tipit kazermë, ato synonin të ndrydhnin aspiratat dhe vrullet rinore e të privonin rininë nga kënaqësitë e moshës, për ta bërë atë “revolucionare”, shërbëtore të nënshtuar të regjimit. Bëmat për ruajtjen e “pastër” të rinisë shkuan deri në dhimbje. Për të ruajtur rininë shkollore nga “reziku” i “përlyerjes” prej modës së huaj, në vitin 1973 Ministria e P. Brendshme do të urdhëronte që të mos lejohej të hynin në Shqipëri “të gjithë ata persona të huaj me paraqitje të jashtme në kundërshtim me normat e moralit tonë socialist, si p.sh. burra me flokë si të grave, me baseta shumë të ekzagjeruara, me mjekra të çrregullta dhe me veshje të papërshtatshme, si femra me mini dhe maksi funde etj.”³² Krahas me këto vazhdonte një propagandë e shfrenuar me shpifje e me sharje, kundër shoqërisë së

³² *AQSh*, Fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, dok. dt. 4.5.1973, nr. 479.

“degjeneruar” borgjeze e revizioniste, të shoqëruar në të njëjtën kohë me lavdërimin e rendit socialist në Shqipëri dhe të “mirat” që gëzonte rinia shkollore prej tij. Mirëpo mendjet rinore, sado të trulllosura që të ishin nga goditjet shokuese të propagandës, prapë, nuk kishin se si të mos kuptonin realitetin. Prandaj brezat e rinj të shoqërisë shqiptare, të cilët dolën nga bankat e shkollës, ishin të traumatizuar në mëdyshjet e forta shpirtërore e mendore, të cilat rridhnin nga kundërshtia midis gënjeshtreve marramendëse zëlarta të shkollës dhe të vërtetave të hidhura të pëshpëritura brenda katër mureve të shtëpisë; të “entuziazmit” në organizatën e rinisë e të pionierit, për jetën e “lumtur” dhe atyre fakteve jetësore që thuheshin vesh më vesh, midis shokësh në rrugë, për rrobat e këpucët e vjetëruara dhe të arnuara, për euforinë e socializmit “fitimtar” që përhapte propaganda e alarmuar puniste dhe për ato që “vidhte” rinia nga stacionet e huaja radiotelevizive.

Fëmijët e vegjël të shkollës 8-vjeçare, të cilët nuk i kapte moshë e detyrimit për aksione e ndeshin rrugëve në një jetë boshe, ku në mënyrë latente kultivohej fara e kotësisë e zbrazëtisë shpirtërore dhe e ligësisë. Kampet verore të pushimit të fëmijëve, si qëndrimet ditore dhe sidomos ato dyjavore në plazhe, të cilët kapnin rreth një muaj në sezon për një turn, nuk përfshinin as edhe një të dhjetën e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të qytetit. Fëmijët e fshatit as që llogariteshin fare, ata ropateshin në punët e rënda të stinëve bujqësore dhe në rrafshje dhe përmasa të tjera, nuk shpëtonin nga e keqja e përgjithshme e kohës. Gjithnjë, me synime politike, për këtë grupmoshë u sajua puna e “dobishme shoqërore” që bëhej dy javë në punët bujqësore në periferi të qyteteve. Po edhe ajo, me mësuës të lodhur nga viti shkollor dhe mjaft mangësi e dobësi materiale e organizative, përfundoi në formalizëm.

Në këto kushte, fëmijët shqiptarë nuk mund t’i shpëtonin valës së “padukshme” rrënuese, të degjenerimit social, i cili kishte nisur të jepte me kohë “frytet” e veta. Në vitet e fundit të regjimit komunist, veprimtaria keqbërëse e shkollarëve, sipas dëshmisë së vetë zv.kryeministrit Manush Myftiu, po ecte me ritme galopante. Në vitin 1986, ajo ishte rritur 21% krahasim me një vit më parë më 1985. “Veç veprave penale, shprehej ai në mbledhjen e qeverisë, nxënësit e shkollave krijojnë edhe akte rrugaçërie, si thyerje xhamash në lokale të ndryshme

(më shumë në shkolla – I.G.), në tregti të ndaluar, sjellje të padenja në shoqëri etj.³³

Në terrene dhe kategori të caktuara shoqërore, krahinore e familjare, mbi karaktere e temperamente të veçantë u kultivuan një mori vesesh. Veçanërisht qytezat e reja industriale e qendrat e banimit pranë kantierëve më të mëdha të ndërtimit, me heterogjenitetin e tyre social e krahinor u bënë “miniera” të “pasura” për kultivimin e dukurive më të shëmtuara sociale.

Përfundimisht, faktet me tërë lakuriqësinë dhe ftohtësinë e tyre flasin për atë që, si gjithë jeta e vendit, edhe arsimit pësoi dëme të mëdha. Breza të tërë i kanë paguar haraç të rëndë “eksperimenteve” që janë bërë në kurriz të arsimit, nga “reforma” në “reformë”, nga pesëvjeçari në pesëvjeçar, për të krijuar “njeriun e ri”, i cili, ndryshe mendonte dhe ndryshe fliste, krijesë e mjeruar e një regjimi pervers, i cili u derdh në kallëpin e një gjysmëshekulli në një shtet-kamp përqendrimi. “Shqipëria u kthye në një vend tejet të zbehtë dhe të varfër në fushën kulturore”³⁴. Në këto kushte, natyrshëm lind pyetja: Vetëm skarcitete nxori shkolla e diktaturës në Shqipëri? Përgjigja është: jo. Është e pamohueshme që nga bankat e shkollës shqiptare dolën edhe kontigjente të formuara nxënësish me qytetari dhe me dituri, të cilët i shërbyen atdheut në lëmenj të ndryshëm të veprimtarisë njerëzore. Por kjo nuk është dhe nuk mund të jetë kurrsesi meritë e sistemit shkollor që sajoi diktatura komuniste në Shqipëri. Është meritë në radhë të parë e formimit të tyre familjar, të atyre kontigjenteve të inteligjencies, e vullnetit dhe etjes së pashuar që kishin ata për të nxënë dituri. Gjithashtu instikti i mbijetesës, gjallëria e vitaliteti i brendshëm mendor, shpirtëror dhe dashuria për jetën, për prindërit, për të afërmit dhe për vendlindjen. Ishte merita e genit të kombit shqiptar, komb i lashtë, i cili ruajti vetë qenien e tij përmes rrebesheve të shekujve dhe që kishte një etje shembullore për progres dhe ëndrra gjithnjë optimiste për prosperitet. Këtu ka vendin e vet shumë të rëndësishëm, puna e atyre mësuesve me frymë të “vjetër” dhe të gjithë mësimeve të tjerë, që u përngjanë atyre në shumë drejtime. Megjithatë, edhe ata shkollarë të cilët arritën të përgatiten mirë në Shqipëri, sidoqoftë nuk dolën dhe nuk mund të dilnin pa mangësi. Prandaj për të plotësuar sa më mirë dijet që morën në shkollë, kjo

³³ *Po aty*, Fondi Kryeministria, dok. dt. 26.4.1987.

³⁴ Miranda Wickers, *Shqiptarët një histori moderne*, Tiranë: 2008, f. 312.

kategori shkollarësh mësoi gjuhë të huaja në kushte shumë të vështira deri në ilegalitet. Në vijim ata studiuuan me dëshirë, gjithnjë në mes të pengesave dhe privacioneve, për t'u specializuar, jo gjithnjë sipas dëshirave dhe prirjeve të tyre, po sipas interesave të partisë dhe të “atdheut”. Sidoqoftë, aq sa u bë në fushë të arsimit, kulturës, shkencës, artit dhe gjithë veprimtarive të tjera gjithëshqiptare, është merita e tyre.

Të ndodhur në mes të Evropës së kulturuar, sado që përjetuan varfëri në një izolim të plotë, një sedër e spikatur e brendshme, e cila rrjedh nga një krenari kombëtare e nxiti pjesën më të shëndoshë të brezave të shkrinte gjithçka të mirë nga vetja për të përthithur kulturë. Ndryshe, po t'ia veshim meritat sistemit socialist shqiptar, çfarë do të thonim për regjimet “reaksonare” të “prapambetura”, borgjeze e revizioniste, që laureatët e atyre vendeve e çuan botën e sotme në zhvillimet marramendëse.

S u m m a r y

THE WOUNDS OF THE ALBANIAN SCHOOL DURING THE COMMUNIST DICTATORSHIP

After the declaration of Independence, the Albanian school started to upraise and during 1920 – 1930s and until 1943, succeeded to install and consolidate an education system. Despite being limited in quantity and with material lacks, this system maintained the Balkan level in methods and substance. After the end of the World War II, this process was interrupted. Being under the doctrine of the communist ideology, school went downwards, at the expense of cultural, civil and patriotic formation of the generations to come in Albania. As soon as the communist government was installed, the reforms against the rotten, bourgeois education system begun, in order to create a new school, called Socialist, with communist aspirations. Under clear political purposes, the expansion of the school network started. Due to school's opening to masses, all school categories were expanded, without having the necessary material basis and obtaining a weak financial support.

The education system during 1944 – 1948, adopted the Yugoslavian system rather than the Russian one, despite the fact that for the moment they were quite similar. It is not by chance that the period of the so-called ‘further revolutionising’ of school coincides with the empowerment of the relations with China. At the end of the ‘70s, after the interruption of the relations with China, school was even more politicized, harming thus even more the cultural formation of the school generations of that time.

Straight after the War, the deterioration of the teacher's personality begun. There was no juridical status for the teacher, in order to regulate the relations of the teachers inside school and society, as a first-hand figure in the cultural evolution of the country.

During the '80s, all the texts and subjects went through a deformation. Formation courses, courses of social sciences, principally history and literature, were mutilated in a degree that harmed the general formation of several generations in Albania. One of the greatest wounds that socialist school brought to the formation of the pupils was the great scarcity in the Albanian language. After the 1946 reform, the western foreign languages were withdrawn from the school programs. There were further measures for revolutionizing school, with the introduction of the so-called revolutionary triangle learning, productive work, physic and military education, all entirely based on the ideological axes of Marxism – Leninism. The objective of the Party – State was to transform school into the principal tool of communist indoctrination. The cultural upraising of generations was not fundamental. The teacher's personality was deteriorated, as well.

It is a reality that, even if the facts are kept nude and cold, they testify that, as the entire life of the country, education suffered great detriments. In the middle of the cultured Europe, in spite of the poverty that they endured inside a total isolation, a particular inner sensibility that flows from a national pride, motivated the healthiest part of the generations towards using every part of them in order to absorb culture.

